

KQZ
U PROTOKOLLUA
NR. 4011 PROT
DATE / 4 27.5.18

RAPORTI I AUDITIT TË PAVARUR

**PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË
SHPENZUARA**

PER VITIN KALENDARIK 2018

"PARTIA SOCIALISTE E SHQIPERISE"

Tirane më, 25 Maj 2019

MODELI 3: MODELI I STANDARTIZUAR PËR RAPORTIMIN E AUDITIMIT TË RAPORTIT VJETOR TË PARTISË POLITIKE.

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

A. INFORMACIONI LIGJOR

i. Kuadri ligjor

Auditimi i Raportit Vjetor të Partisë Socialiste të Shqipërisë është i mbështetur në :

- Ligjit Nr.10019 datë 29.12.2008 " Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë " i ndryshuar me Ligjin Nr. 74/2012 datë 19.07.2012 dhe Ligjin Nr. 31/2015 datë 02.04.2015 ,
- Ligjit Nr. 8580 datë 17.02.2000 " Ligji për Partitë Politike " i ndryshuar me Ligjin Nr.10374 datë 10.02.2011 , Ligji Nr.17/2014 datë 20.02.2014 dhe , Ligjin Nr. 25/2014 datë 25.09.2014 , Ligji Nr. 90/2017 " Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8580 datë 17.02.2000 " .
- Ligjin Nr. 10091 datë 05.03.2009 " Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të rregjistruar dhe të kontabilistit të miratuar " të ndryshuar , Ligji Nr. 47/2016 datë 28.04.2016 " Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10091 datë 05.03.2009 " Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të rregjistruar dhe të kontabilistit të miratuar " të ndryshuar .
- Ligji Nr. 9228 datë 29.04.2004 " Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare " ndryshuar me Ligjin Nr. 9477 datë 09.02.2006.
- Ligji Nr. 8788 datë 07.05.2001 " Për organizatat jo fitimprurëse" i ndryshuar me Ligjin Nr. 92/13 datë 28.02.2013 dhe , Ligji Nr.8779 datë 07.05.2001 " Për rregjistrimin e organizatave jo fitimprurëse".
- Vendimi i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve Nr. 152 date 11.04.2019 " Për miratimin e formateve të standartizuara të raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik, raportit të auditimit të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për fushatën zgjedhore dhe raportit të monitorimit të fushatës zgjedhore " .
- Vendimi i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve Nr. 112 datë 27.03.2019 " Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar , të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2018 , " .



Miratuar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019

- Vendime , udhëzime dhe akte të tjera të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve si dhe çdo dokument ligjor të marrë pranë Partisë Socialiste të Shqipërisë , legjislacioni fiskal dhe akte të tjera ligjore e nënligjore të shtetit shqiptar.

ii. Standartet e kontabilitetit të zbatueshme

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në standartet kombëtare të kontabilitetit për OJF i shpallur nga ministri i financave me urdhërin Nr.62 datë 17.09.2015 në mbështetje të pikes 1 të Ligjit Nr.9228 datë 29.04.2004 " Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare " , i ndryshuar me ligjin Nr. 9477 datë 09.02.2006 dhe të Vendimit Nr 2 datë 27.07.2015 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit " Për miratimin e Standartit Kombëtar të OJF " , i detyrueshëm për t'u zbatuar nga data 01.01.2016.

Përgatitja e pasqyrave financiare është bërë në zbatim të SKK 1. Pasqyrat financiare të konsoliduara të PS janë përgatitur mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin dhe jo kur arkëtohen ose paguhen e, njihen në kontabilitet dhe raportohen në pasqyrat financiare të periudhës kontabël të cilave ju përkasin.

Auditimi i pasqyrave financiare të periudhës 01.01.2018 deri 31.12.2018 të Partisë Socialiste u kryen në mbështetje të SNA 800 dhe IFRS 4400.

B. OBJEKTI I AUDITIMIT

i. Kontrata e shërbimit

Kontrata e shërbimit është lidhur në datë 23.04.2019 me Nr. Protokolli 1355/1 me KQZ dhe ka për objekt kryerjen e auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2018 për partitë politike në përputhje me Ligjin Nr.8580 datë 17.02.2000 " Ligji për Partitë Politike " i ndryshuar aktet nënligjore të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve të miratuara për këtë qëllim, me Ligjin Nr.10091 datë 05.03.2009 " Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të rregjistruar dhe të kontabilistit të miratuar " dhe Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 " Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare " ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre.

ii. Vendimi i KQZ-së

Vendimi Nr. 112 datë 27.03.2019 i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve " Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar , të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përftuara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin kalendarik 2018 .

iii. Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor.

Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve është i detyruar të njoftojë menjëherë audituesin dhe të japë të dhënat e partisë që auditohet ku përfshihen :



Miratuar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019

- a.-Adresa, sipas të dhënave në regjistrin e partive politike të regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë
- b.- Emrin /mblemrin dhe adresën e kryetarit dhe të financierit të partisë .
- Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve është i detyruar të paguajë çmimin përkatës të përcaktuar në nenin 4 të kësaj kontrate.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sigurtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombetare të Kontabilitetit, " Kodin zgjedhor të Republikës së Shqipërisë " i miratuar me Ligjin Nr.10019 datë 29.12.2008 i ndryshuar me Ligjin Nr.74/2012 datë 19.07.2012 dhe Ligjin Nr.31/2015 datë 02.04.2015 si dhe Ligjin Nr. 8580 date 17.02.2000 " Për Partitë Politike " i ndryshuar me Ligjin Nr.10374 datë 10.02.2011 , Ligjin Nr.17/2014 datë 20.12.2014 dhe Ligjin 25/2014 datë 25.09.2014 dhe për ato kontrolle të brëndëshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale , për shkak të mashtrimit apo të gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare drejtimi është përgjegjës për vlerësimin edhe të aftësisë të partisë për të vazhduar në vijimësi , duke dhënë informacion shpjegues kur është e aplikueshme, çështjet që lidhen me vijimësinë duke përdorur bazën kontabël të vijimësisë nëse menaxhimi nuk synon likuidimin ose të ndërpresë operacionet , ose kur nuk ka ndonjë alternativë tjetër realiste por vetëm të veprojë në këtë mënyrë.

Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm mbil paraqitjen e sigurtë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të përshtatshme kontabël, dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të asyeshme për rrethanat.

Personat e ngarkuar me qeverjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të partisë.

Audituesi ligjor merr përsipër kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në nenin 1 të kontratës së shërbimit të lidhur me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve , në ambjentet e partisë politike që auditohet.

Audituesi ligjor duhet të verifikojë çdo dokument, informacion, llogarit bankare apo të dhënë që ka të bëjë me financimin dhe shpenzimet e kryera nga partia politike si dhe të marrë deklarata nga drejtuesit e partisë politike që auditohet për çështjet që nevojiten për të kryer shërbimin.

Audituesi ligjor duhet të kryejë kontrolle të dokumentave financiare e të llogarive kontabël si dhe të subjekteve të lidhura drejtpërdrejt apo tërthorazi me partinë politike apo që ndodhen nën kontrollin e tyre.

Audituesi ligjor duhet të depozitofë në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve raportin e auditimit brënda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontrates , si dhe të depozitohet edhe në format elektronik.

Audituesi ligjor duhet të dorëzojë së bashku me raportin edhe pyetesorin udhëzues së bashku me kontratën.

Audituesi ligjor duhet të hartojë raportin e auditimit me profesionalizëm sipas formatit të standartizuar të miratuar nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve me vendimin Nr.152 datë 11.04.2019 në përputhje me ligjin Nr. 8580 datë 17.02.2000 " Për Partitë Politike " i ndryshuar Ligjin Nr. 10091 datë 05.03.2009 " Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit



Miratuar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019

kontabël të rregjistruar dhe të kontabilistit të miratuar ", dhe Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 " Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare " ndryshuar si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre.

Audituesi ligjor nuk mund të përfshijë në raportin e auditimit të dhënat personale të personave që i kanë dhuruar partisë shuma më pak se 100.000 lekë.

Audituesi ligjor duhet të paraqitet në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve sa herë kjo e fundit e kërkon për sqarime të mëvonëshme pas depozitimit të raportit përfundimtar.

Audituesi ligjor në çdo rast duhet të njoftojë për kryerjen e auditimit ligjor partinë politike me shkrim nëpërmjet postës shqiptare sipas adresës së dhënë nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë.

Në raportin e auditimit audituesi përfshin opinionin e tij bazuar në sigurinë e arsyeshme nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi janë pa gabime materiale qoftë për shkak mashtrimi apo gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA gjithmonë do të zbulojë një anomal materialle kur ajo ekziston. Anomalitë mund të shkaktohen nga mashtrimi apo gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra mbi baza të këtyre pasqyrave financiare.

C. **PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR TEK AUDITUESI LIGJOR**

I. Prezantimi i subjektit zgjedhor

Partia Socialiste e Shqipërisë është rregjistruar në rregjistrin e Partive politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me urdhër të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 36/1 datë 15.08.1991 me emrin " Partia Socialiste e Shqipërisë " me iniale " PS ".

Kryetari i saj është Zoti Edi Rama .

Ajo është e rregjistruar në organet tatimore në datën 29.01.2007 me NIPT K 71329002 F . Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave të Ligjit Nr. 8580 datë 17.02.2000 " Për Partitë Politike " , Ligji Nr. 8788 datë 07.05.2001 " Për organizatat jo fitimprurëse " , Ligji Nr.8779 datë 07.05.2001 " Për rregjistrimin e organizatave jo fitim prurëse " , nga statuti i saj dhe legjislacioni në fuqi.

Selia e partisë është në adresën : Sheshi " Austri " Nr. 91 Tiranë .

ii. Forma e organizimit dhe menaxhimit (qendra dhe degët rajonale): numri i anëtarëve, struktura dhe numri i degëve në qark dhe organizatat që kanë lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me partinë (për shembull, fondacionet, organizatat e rinisë, etj.)

Organet drejtuese në udhëheqjen qendrore të Partisë Socialiste janë :

Kongresi i Partisë - organi më i lartë vendim marrës i Partisë

Asambleja Kombëtare - organi më i lartë midis dy kongreseve

Kryetari i partisë - drejtuesi më i lartë politik i Partisë



Miratuar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019

Kryesia e partisë

Organet drejtuese në rrethe të cilat janë përcaktuar në statutin e partisë :

Asambleja socialiste e bashkisë

Kryetari i partisë i asamblesë socialiste të bashkisë

Organet vendore të Partisë Socialiste janë :

Organizata socialiste

Këshilla socialiste të njësive administrative

Keshilli koordinues te partise socialiste ne qarqe

D. **PREZANTIMI I RAPORTI DHE STRUKTURAT E TIJ**

i. Struktura e raportit të auditimit - kërkesat formale, të ardhurat dhe shpenzimet.

Struktura e raportit të auditimit përbëhet nga :

- Kërkesa formale ku jepet një pasqyrim i përgjithshëm i pasqtrave financiare në datën e dorëzimit dhe të nënshkrimit të saj , të auditit , të aktiveve dhe detyrimeve të Partisë në datën 31.012.2018
- Të ardhurat e Partisë të realizuara gjatë perludhës 01.01.2018 deri në 31.12.2018 si dhe nje informacion më i plotë për burimin e këtyre të ardhurave .
- Të shpenzimeve të kryera nga Partia gjatë periudhës një vjeçare që fillon nga 01.01.2018 deri në 31.12.2018 së bashku me analizën përkatëse të tyre sipas llojit të shpenzimeve dhe përkatësisë.
- Së fundi një sintezë ku përmbliidhen të gjitha gjetjet gjat procesit të auditimit dhe dhënia e opinionit të certifikimit.

ii. Përmenden takimet dhe komunikimet e mundëshme midis audituesit dhe subjektit zgjedhor dhe çdo personi tjetër të tretë.

Në punën tonë për auditimin e fondeve dhe të shpenzimeve të kryera gjatë vitit kalendarik 2018 kemi marrë kontakt me Znj Dhurata Isufaj Kryefinancierja e Partisë Socialiste dhe Znj. Zeneida Ilnica financierja e Partisë Socialiste.

iii. Jepet një paraqitje e përgjithshme në lidhje me raportin vjetor të partisë politike: nëse është ose jo në përputhje me kërkesat e raportimit.

Raportit vjetor i Partisë Socialiste është dorëzuar në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve me Nr.Protokollit 3 datë 5.02.2018 dhe është i mbështetur në vendimin Nr.3 datë 18.01.2011 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve . Ai është hartuar në përputhje me kërkesat e raportimit sipas lidhjes 2 të Vendimit Nr.3 datë 18.01.2011 " Për raportimin financiar vjetor të partive".



Miraturar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019

Është l ndërtuar me 4 rubrika të cilat janë të shtjelluara si 1.1 informacion l përgjithshëm 1.2 të ardhurat 1.3 shpenzimet 1.4 aktivet dhe pasivet.

Pasqyra financiare janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat jo Fitimprurese (SKK për OJF-të), dhe me kërkesat e Ligji Nr. 9228 datë 29.04.2004 " Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare " .

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara të kontabilitetit. Mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, elementët njihen si aktive, detyrime, aktive neto, të ardhura apo shpenzime kur ato plotësojnë përkufizimet dhe kriteret e njohjes për këto zëra.

Për matjen e vlerave monetare të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, në pasqyrat e saj financiare, Partia Socialiste ka zgjedhur si bazë matjeje kosto historike.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci , zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit .

Matja fillestare e të arkëtueshmëve dhe pagueshmëve bëhet me vlerën e drejtë dhe më pas njihen me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provizionet për zhvlerësim. Interesi mbi të arkëtueshmet e pakthyera njihet mbi bazën e kontabilitetit të të drejtave të konstatuara.

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK 04- Njohja e Inventarëve bëhet zakonisht në momentin e përfitimit. Vlerësimi i mëpastajshëm, pas njohjes fillestare, matet me vlerën më të ulët midis koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me koston për t'u përfunduar dhe shitur.

Aktivt afatgjata materiale (AAM-të) njihen si një aktiv vetëm nëse: aktivi kontrollohet nga partia , është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i aktivit të hyrë dhe kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri. Regjistrimi fillestar i aktiveve afatgjata materiale bëhet zakonisht në momentin e përfitimit të tij nga blerja apo prodhimi dhe matet me kosto.

Në pasqyrën e pozicionit financiar një element i aktivit afatgjatë material paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpastajshme i shtohen koston së aktiveve afatgjata materiale vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të këtyre aktiveve dhe kriteret për njohjen e tyre në pasqyrën financiare. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrmor.

Amortizimi llogaritet mbi bazën e metodës së vlerës së mbetur për të gjitha vitet e jetës ekonomike të aktivit, me norma vjetore, për ndërtesat nuk është llogaritur amortizim dhe të tjerat me 20% e 25 % .

II. KËRKESAT FORMALE



Miraturar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019

A. PËRMBLEDHJE

1/ Data e dorëzimit të raportit vjetor			
	Dorëzimi fizik	Po	Data 05.02.2019
2/ Nënshkrimi			
	Nënshkrimi	Po	Data 05.02.2019
	Identiteti i nënshkruesit	Po	Emër Dhurata Isufaj

B. ÇAKTIMI I AUDITUESIT LIGJOR DHE LLOGARISË BANKARE

1/ Informacioni për parti të politike		
	Emri i partisë politike	Partia Socialiste e Shqipërisë
	Adresa e selisë qendrore	Sheshi " Austria " Nr. 91 , Tiranë
	Numri i telefonit të selisë qendrore	00 355 42 224 738
	Adresa e e-mailit të selisë qendrore të partisë (nëse ka)	S ka (web : www.ps.al)
2/ Informacion për audituesin ligjor		
	Emri i audituesit ligjor të caktuar	Margarita Gjergji
	Adresa e audituesit ligjor	Rruga e Durrësit, 124/3/24, Tiranë
	Numri i telefonit të audituesit ligjor	069 21 16 126
	Adresa e e-mailit të audituesit ligjor (nëse ka)	Margarita.gjergji@yahoo.com
3/ Të dhënat e llogarisë bankare të partisë politike		
a.	Emri i bankës ku mbahet llogaria	Credins Bank në ALL
	Adresa e zyrës së bankës ku mbahet llogaria	Banka Credins Dega Tirana 1, Tiranë
	Numri i telefonit të zyrës së bankës	042234096
	Adresa e e-mailit të zyrës së bankës apo zyrtarit përgjegjës të bankës	Entela.haxhialiu@bankacredins.com
	Numri i llogarisë bankare	00000112879
	Emrat dhe nënshkrimi i të gjithë personave të autorizuar për	Dhurata Isufaj, Zeneida Ilnica



Miratuar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019

	veprimet tek llogaria bankare	
b.	Emri i bankës ku mbahet llogaria	Credins Bank ne C
	Adresa e zyrës së bankës ku mbahet llogaria	Banka Credins Dega Tirana 1,Tiranë
	Numri i telefonit të zyrës së bankës	042234096
	Adresa e e-mailit të zyrës së bankës apo zyrtarit përgjegjës të bankës	Entela.haxhialiu@bankacredins.com
	Numri i llogarisë bankare	00000456908
	Emrat dhe nënshkrimi i të gjithë personave të autorizuar për veprimet tek llogaria bankare	Dhurata Isufaj , Zeneida Ilnica
c.	Emri i bankës ku mbahet llogaria	Credins Bank ne §
	Adresa e zyrës së bankës ku mbahet llogaria	Banka Credins Dega Tirana 1,Tiranë
	Numri i telefonit të zyrës së bankës	042234096
	Adresa e e-mailit të zyrës së bankës apo zyrtarit përgjegjës të bankës	Entela.haxhialiu@bankacredins.com
	Numri i llogarisë bankare	00000288407
	Emrat dhe nënshkrimi i të gjithë personave të autorizuar për veprimet tek llogaria bankare	Dhurata Isufaj , Zeneida Ilnica
d.	Emri i bankës ku mbahet llogaria	Credins Bank ne ALL
	Adresa e zyrës së bankës ku mbahet llogaria	Banka Credins Dega Tirana 1,Tiranë
	Numri i telefonit të zyrës së bankës	042234096
	Adresa e e-mailit të zyrës së bankës apo zyrtarit përgjegjës të bankës	Entela.haxhialiu@bankacredins.com
	Numri i llogarisë bankare	00000288405
	Emrat dhe nënshkrimi i të gjithë personave të autorizuar për veprimet tek llogaria bankare	Dhurata Isufaj , Zeneida Ilnica
e.	Emri i bankës ku mbahet llogaria	Credins Bank ne E
	Adresa e zyrës së bankës ku mbahet llogaria	Banka Credins Dega Tirana 1,Tiranë
	Numri i telefonit të zyrës së bankës	042234096
	Adresa e e-mailit të zyrës së bankës apo zyrtarit përgjegjës të bankës	Entela.haxhialiu@bankacredins.com



Miratuar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019

	Numri i llogarisë bankare	00000283718
	Emrat dhe nënshkrimi i të gjithë personave të autorizuar për veprimet tek llogaria bankare	Dhurata Isufaj , Zeneida Ilnica
f.	Emri i bankës ku mbahet llogaria	BKT ne ALL
	Adresa e zyrës së bankës ku mbahet llogaria	Dega qendrore sheshi Italia pranë hotel Sheraton, Tiranë
	Numri i telefonit të zyrës së bankës	+35542266277
	Adresa e e-mailit të zyrës së bankës apo zyrtarit përgjegjës të bankës	info@bkt.com.al
	Numri i llogarisë bankare	110000601
	Emrat dhe nënshkrimi i të gjithë personave të autorizuar për veprimet tek llogaria bankare	Dhurata Isufaj , Zeneida Ilnica

C. AKTIVET DHE DETYRIMET

1/ Kriteret e klasifikimit të aktiveve	
	<p>Përshkruani natyrën e secilit aktiv, pronë e partisë, në datën e vlerësimit</p> <p>Ndërtesa Mjete transporti Inventar ekonomik (paisje dhe orendi zyre) Paisje e programe Informatike</p> <p>Përshkruani vendndodhjen e aktivit : Në selinë qendrore të Partisë Socialiste</p> <p>Shkruani vlerën e tregut të aktivit, në datën e vlerësimit nëse është bërë vlerësim, ose vlerën kontabël të mbetur</p> <p>Ndërtesa1.643.389 vlerë fillestare Mjete transporti.....2.036.368 vlerë kontabël e mbetur Inventar ekonomik (paisje dhe orendi zyre)..... 3.425.982 vlerë kontabël e mbetur Paisje e programe informatike4.113.045 vlerë kontabël e mbetur</p>
2/ Kriteret e klasifikimit të detyrimeve	
	<p>Përshkruani llojin e secilit detyrim të partisë, në datën e vlerësimit :</p> <p>Në datën e vlerësimit detyrimet e Partisë Socialiste janë detyrime për sigurime shoqërore e shëndetësore , detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale si dhe detyrime për reklama e shërbime të tjera publligjstike ku këto të fundit zënë 98.7% të shumës së detyrimeve dhe që janë vlera të mbartura .</p> <p>Shkruani emrin e kreditorit për detyrimet</p>



Miratuar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019

<p>Kreditorët për detyrime janë :</p> <p>Top Albania Radio, Synclab , Prosound shpk, Media vizion sha, A 1 Report, Ora sha, Top Chanel, Shqiptarja.com, Elda shpk, Dixhi Print, Drejtoria e sigurimeve shoqërore e shëndetësore Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e tatim taksave Tiranë , Autostar Albania sh.p.k.</p>
<p>Shkruani vlerën e detyrimit në datën e vlerësimit dhe kushtet e shlyerjeve</p>
<p>Furnitorët gjëndje e mbartur nga viti 2017 :</p>
<p>Top Albania Radlo.....500.000 Synclab..... 26.150 Prosound shpk.....696.000 Media vizion sha.....7.714.033 A 1 Report.....6.306.241 Ora sha.....36.677.520 Top Chanel.....80.743.328 Shqiptarja.com..... 3.338.290 Elda shpk..... 285.500 Dixhi Print..... 208.355 Autostar Albania sh.p.k..... 811.314</p>
<p>dhe</p> <p>Drejtoria Rajonale e tatim taksave Tiranë (slg.shoq.shëndet.).....1.281.570 Drejtoria Rajonale e tatim taksave Tiranë (tatim page)..... 515.002</p>

D. PËRMBLEDHJE FINANCIARE

Përmbledhje Financiare	
Periudha e raportimit (data e parë dhe e fundit e periudhës që mbulon raportin)	01.01.2018 deri më 31.12.2018
Shuma e parave në arkë në fillim dhe në fund të periudhës së raportimit (data e parë dhe e fundit e periudhës që mbulon raportin)	01.01.2018 - 131.563 31.12.2018 - 535.639
Shuma e përgjithshme e të gjithë kontributeve të marra	92.440.052
Shuma e përgjithshme e të gjitha shpenzimeve të bëra,	98.253.982
Bilanci në fund të periudhës së raportimit (data e fundit që mbulon periudhën)	31.12.2018
Shuma e përgjithshme e të gjithë aktiveve në fund të periudhës së raportimit	11.218.784
Shuma e përgjithshme e të gjithë detyrimeve në fund të periudhës së raportimit,	139.103.303

a/ Llogari bankare e vecantë e partisë politike dhe Audituesi Ligjor

Llogaria bankare e posaçme?



Miratuar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019

A është siguruar i gjithë Informacioni? Po.

- o Evidenca e hapjes së llogarisë bankare (data, dokumenti nga banka) . Llogaria bankare nr.112879 në lekë datë 30.08.2018.
- o Dokumenti i lëvizjeve në llogarinë bankare (bank statement) për të gjithë vitin financiar . (Shih dokumentin bashkëngjitur). Lëvizja në llogarinë bankare është bërë në datën 30.08.2018.

- **Identiteti i audituesit Ilgjor**

- o Kush?

Margarita Gjergji , Audit Ligjor me Nr. Licensë 026 datë 10.02.2000 lëshuar nga IEKA.

- o Çështja e mospërputhjeve të mundëshme.

Është lëshuar deklaratë panvarësie datë 08.03.2019.

- **Përgjegjësi për përgatitjen dhe nënshkrimin e raportit vjetor.**

- o Nënshkrimi i raportit vjetor.
- o Nënshkrimi i raportit vjetor është bërë nga kryefinancierja Znj.Dhurata Isufaj.
- o Paraqitja e të gjithë dokumenteve mbështetëse: vërejtja e problemeve të dukshme (shiko më poshtë)

a) bosh/mungon informacioni	Po / Jo	Çfarë?	
b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë)			
	Të Ardhurat		92.440.052
		Financime publike	85.065.992
		Donacione private (Qira)	500.000
		Financim nga burimet e veta të partisë	6.804.560
		Hua/Kredi, Te tjera	69.500
	Shpenzime		98.253.982
		Shpenzimet e qerasë	1.171.000



Miraturar me Vendim nr. 152 datë 11.04.2019

		Stafi / rrogat	83.722.774
		Medla	
		Komunikimi	1.063.374
		Transporti	2.486.552
		Shpenzimet bankare	156.736
		Administrative dhe të Përgjithshme	5.862.151
		Amortizimi	509.092
		Menaxhimi i Pronës	
		Shpenzime të tjera	3.282.303

b/ Asetet/detyrimet dhe përmbledhjet financiare

- Çdo mospërputhje / parregullsi në lidhje me deklarimin e aktiveve dhe detyrimeve.

Gjatë auditimit të aktiveve dhe detyrime nuk është vërejtur asnjë parregullsi apo mospërputhje të dhënash .

- Defiçit/ shpenzime të papaguara

Gjatë vitit ushtrimor 01.01.2018 deri në 31.12.2018 janë 5.813.930 lekë shpenzime të papaguara.

III. TË ARDHURAT

A. PËRMBLEDHJE

		Sipas raportit vjetor	Sipas auditimit të kryer
1/ Financimi publik			
	Shuma e granteve publike të marra	85.065.992	85.065.992
	Data e tranfertës	04.04.2018, 25.04.2018, 07.08.2018, 09.10.2018.	04.04.2018, 25.04.2018, 07.08.2018, 09.10.2018.
2/ Donacionet private			
	Shuma e përgjithshme e raportuar	700.000	700.000
	Shuma e donacioneve në para	700.000	700.000



Miratuar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019

Shuma e donacioneve në natyrë	0	0
Paraqitja e një liste të donatorëve		Shefki Rama
Paraqitja e të gjitha deklarimeve bankare		Albiona Sulo
Përputhshmëria mes çdo donacioni të raportuar dhe deklarimit bankar (shuma)		Date 11.09.2018
Përputhshmëria mes çdo donacioni të raportuar dhe deklarimit bankar (data)		700.000
Përputhshmëria mes çdo donacioni të raportuar dhe deklarimit bankar (donatori)		30.08.2018
Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data)		Shefki Rama Albiona Sulo
A përputhen shifrat e përgjithshme?		Nuk ka
Respektimi i kufirit të donacionit		Po
3/ Financimi nga burimet e vetë partisë		
Shuma e përgjithshme e raportuar	6.804.560	6.804.560
Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)	6.804.560	6.804.560
Kuotat e anëtarësisë	4.004.010	4.004.010
Botimet		
Shtypshkronja		
Marrje me qera	500.000	500.000
Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)	2.100.550	2.100.550
Kuotat e anëtarësisë		
Botimet		
Shtypshkronja		
Marrje me qera		
Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe deklarimit bankar (shuma)		4,704,010 2.100.550
Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe deklarimit bankar (data)		01.01.2018 deri 31.12.2018
4/ Huatë/Kreditë		



Miratuar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019

Shuma e përgjithshme e raportuar	1,733,123	1,733,123
Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)	921,809	921,809
Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)	01.01.2018 deri 31.12.2018	01.01.2018 deri 31.12.2018
Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilin kredi / hua)		Autostar Albania sh.p.k
5/ Marrja e të ardhurave		
Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë përkatëse.	Po	Po

Kontributet e Specifikuara

Kriteret e kontributeve	
Emri i kontribuesit -	Nuk ka
Adresa e kontribuesit -	Nuk ka
Profesioni i kontribuesit (nëse kontribuesit nuk ka profesion, shkruani "nuk ka profesion") -	Nuk ka
Përshkrimi i kontributit (i tillë si "para në dorë" apo "çek" apo "transfertë bankare" apo "përshkrimi i kontributit në natyrë") -	Nuk ka
Vlera e kontributit (për kontributet në natyrë shkruani vlerën e tregut, që është vlera e sendit nëse shitet në atë gjendje aktuale) -	Nuk ka
Data kur është marrë kontributi -	Nuk ka

B. ANALIZA

a/ Financimi nga burimet jo publike

- Donatorët e lejuar:

- o Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar;



Miratuar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019

Neni 21 I Ligjit Nr. 8580 datë 17.2.2000 Ndryshuar me Ligjin Nr. 10374, datë 10.2.2011 Ligjin Nr. 17/2014, datë 20.2.2014 Ligjin Nr. 25/2014, datë 25.9.2014 përcakton se " Lejohen dhuratat dhe ndihmat që vijnë nga parti ose bashkime ndërkombëtare partish, nga organizata e fondacione politike, vendase e të huaja, si dhe nga individë, persona fizikë e juridikë privatë vendas ", sikurse Neni 23/1 (ndryshuar me ligjin nr. 10374, datë 10.2.2011) vë në dukje se

1. Çdo parti politike duhet të regjistrojë në një regjistër të posaçëm, sipas formatit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shumën e fondeve të përfituara nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhëna që lldhen me identifikimin e qartë të dhuruesit. Në çdo rast, dhuruesi, në kohën e dhurimit, nënshkruan detyrimisht një deklaratë dhurimi, sipas formatit të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Lista e personave, që dhurojnë shuma jo më pak se 100 mijë lekë, si dhe vlera përkatëse, duhet të bëhen kurdoherë publike.

